


HEALTH CORRUPTION SCAN



HULUMTIM I OPINIONIT PUBLIK

Korrupsioni në Institucionet
e Kujdesit Shëndetësor
Publik në Kosovë

2016

Korrupsioni në Institucionet e Kujdesit Shëndetësor Publik në Kosovë

Shkurt, 2016

Ky hulumtim është realizuar me përkrahjen nga Fondi Kanadez për Nisma Lokale (CFLI). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Qeverisë Kanadeze.

Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives
Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales



Përmbledhje Ekzekutive	5
1. Hyrje.....	7
Kujdesi Shëndetësor Publik në Kosovë	8
2. Metodologjia dhe mostra e hulumtimit	9
3. Rezultatet e studimit	12
4. Përfundime.....	29
Referenca	31
Falënderime	32
Rreth Lëvizjes FOL.....	33

Lista e Figurave

Figura 1 - Vizitat në institucionet e kujdesit shëndetësor gjatë vitit 2015 (P1)	12
Figura 2 - Niveli i kënaqësisë me shërbimet shëndetësore e institucioneve të mëposhtme (P2)	13
Figura 3 - Niveli i korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor sipas qytetarëve (P3)	13
Figura 4 - Niveli i korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor sipas qytetarëve dhe sipas rajoneve (P3)	14
Figura 5 - Niveli i korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor sipas qytetarëve dhe zonave të banimit (P3)	14
Figura 6 - Perceptimi mbi nivelin e korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor (P4)	15
Figura 7 - Përgjegjësitë për nivelin e korrupsionit në shëndetësi (P5)	16
Figura 8 - Përceptimet mbi ndryshimin në nivelin e korrupsionit në sistemin shëndetësor publik (P6)	16
Figura 9 - Përceptimet e qytetarëve për zbatimin e politikave apo masave efektive kundër korrupsionit në shëndetësi nga autoritetet publike vendore (P7).....	17
Figura 10 - Rastet kur shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike dhe jeni detyruar që të shkoni në ato private (P8).....	17
Figura 11 - Rastet kur shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike dhe jeni detyruar që të shkoni në ato private sipas rajoneve (P8).....	18
Figura 12 - Pajtimi me deklaratat për sistemin shëndetësor publik në Kosovë (1) (P9).....	19
Figura 13 - Pajtimi me deklaratat për sistemin shëndetësor publik në Kosovë (2) (P10).....	20
Figura 14 - Pajtimi me deklaratën: "Institucionet publike të kujdesit shëndetësor kanë të ndërtuar mekanizma dhe i respektojnë ato për të ndëshkuar doktorët dhe stafin tjetër të përfshirë në rastet korruptive." (P11)	21
Figura 15 - Shfrytëzimi i lidhjeve personale ose familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore (P12)	21
Figura 16 - Shfrytëzimi i lidhjeve personale ose familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore (P12)	22
Figura 17 - Dhënia e parave apo të mirave të tjera jo monetare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit (P13).....	22
Figura 18 - Dhënia e parave apo të mirave të tjera jo monetare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore Gjatë 12 muajve të fundit sipas gjinisë (P13)	23
Figura 19 - Numri i rasteve të dhënies së parave ose të mirave materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë vitit 2015 (P13a).....	23
Figura 20 - Vlera monetare e parave ose të mirave materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë vitit 2015 (P14)	24
Figura 21 - Vlera monetare e parave ose të mirave materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë vitit 2015 sipas gjinisë (P14)	25
Figura 22 - Arsyet e dhënies së parave dhe të mirave material (P15)	26
Figura 23 - Arsyet e dhënies së parave apo të mirave materiale (P15)	26
Figura 24 - Paraqitja e rasteve të korrupsionit para autoriteteve/institucioneve zyrtare (P16)27	

Figura 25 - Arsyet e mosparaqitjes të rasteve të korrupsionit tek institucionet përkatëse (P19).....	28
Figura 26 - Arsyet e mosparaqitjes të rasteve të korrupsionit tek institucionet përkatëse sipas gjinisë (P19)	28

Lëvizja FOL në periudhën Janar-Shkurt të këtij viti ka zhvilluar një hulumtim të opinionit publik rreth perceptimeve dhe përvojave në raport me korrupsionin në sistemin e kujdesit shëndetësor publik. Ky hulumtim është pjesë e një projekti madhor që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit. Hulumtimi u zhvillua duke intervistuar qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeç që kanë përdorur shërbimet e ofruara nga ky sistem të paktën një herë gjatë vitit 2015. Studimi u shtri në të gjitha komunat e Kosovës. Të gjeturat e këtij studimit do të analizohen përgjatë këtij raporti – megjithatë të gjeturat kryesore janë si më poshtë:

Të gjeturat kryesore

- Qendrat e Mjekësisë Familjare ishin institucionet më të vizituara nga qytetarët dhe institucionet me të cilat ata janë ndarë më të kënaqur për cilësinë e shërbimeve gjatë vitit 2015.
- Afër 15 për qind e të anketuarve mendojnë se korrupsioni në institucionet e shëndetit publik në Kosovë është 'shumë i lartë' e 47 për qind të tjerë mendojnë se është 'deri diku i lartë'. Rajoni i Pejës ka përqindjen më të lartë të qytetarëve me perceptime të tilla e Ferizaj ka përqindjen më të ulët. Qytetarët mendonin se institucioni më i korruptuar është Qendra Klinike Universitare e Kosovës e ato më së paku të korruptuara ishin Qendrat e Mjekësisë Familjare. Personeli mjekësor (38%) dhe qeveria e Kosovës (30%) janë të etiketuar si fajtorët për nivelin e korrupsionit.
- Shumica mendojnë se niveli i korrupsionit ka mbetur i njëjtë në këtë sektor dhe një pjesë e madhe e të anketuarve (40%) mendojnë se asnjë veprim i mirëfilltë nuk po ndërmerret për këtë problem, e një pjesë tjetër pothuajse e barabartë (39%) janë ndarë të pakënaqur me masat e zbatuara.
- Afër 73 për qind e qytetarëve janë ndeshur shpesh apo gjithmonë në situata ku shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike dhe si pasojë, ata kanë qenë të detyruar të shkojnë në institucione private për t'i adresuar problemet e tyre shëndetësore. Sipas tyre problemet me korrupsionin në stafin e institucioneve publike ekzistojnë që nga infermierët e deri te doktorët, si dhe nga vetë qytetarët që japin para apo të mira materiale (jo monetare). Mirëpo më së shumti qytetarë janë pajtuar me deklaratat për praktikat korruptive të doktorëve, si për shembull referimi i pacientëve në ordinancat e tyre private ose spitalet/klinikat private ku ata punojnë, etj.
- Rreth 28 për qind e të anketuarve kanë shfrytëzuar lidhjet e tyre personale apo ato familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit dhe afër 10 për qind nuk kanë pranuar të përgjigjen. Rajonet me më së shumti individë që kanë pranuar shfrytëzimin e lidhjeve personale janë Peja e Gjakova, ku afër gjysma e të anketuarve (48%) kanë pohuar një gjë të tillë.
- Për më tepër, 16 për qind e të anketuarve kanë pranuar se kanë dhënë para për të marrë shërbime më të mira nga institucionet publike shëndetësore dhe 9 për qind kanë pohuar dhënien e të mirave materiale (jo monetare) për të njëjtin qëllim. Ata kanë dhënë së paku 1 herë e më së shumti 5 herë para ose të mira materiale gjatë 2015-

tës. Mesatarja për dhënien e të mirave materiale është 1.92 herë, e për para është 1.84. Shuma monetare minimale e ryshfetiit është 5 euro e ajo maksimale 600 euro ndërsa shuma mesatare ishte rreth 101 euro e ajo mediane afër 63 euro.

- Dhënia e parave është më e përhapur te gjinia mashkullore se ajo femërore. Gjithashtu meshkujt kanë dhënë mesatarisht sasi më të mëdha se femrat. Rreth 66 për qind e të anketuarve që kanë dhënë vetëm para, kanë pohuar se kanë qenë të kushtëzuar nga stafi i kujdesit shëndetësor publik ndërsa 89 për qind e të anketuarve që kanë dhënë vetëm të mira materiale, kanë deklaruar se e kanë bërë atë në mënyrë vullnetare.
- Raportimi i këtyre rasteve të korrupsionit pothuajse nuk ndodh asnjëherë sipas përgjigjeve të qytetarëve, në vetëm 2 për qind të rasteve. Më shumë se 25 për qind e të anketuarve nuk e shohin të arsyeshëm raportimin sepse ata kanë pasur dobi nga dhënia e parave/dhuratave. Ndërsa rreth 24 për qind nuk raportojnë ngase mendojnë se askush nuk do t'ia dijë për raportimin e rasteve të korrupsionit. Gjithashtu një përqindje e madhe e të anketuarve (20%) dhënien e parave apo të mirave materiale nuk e raportojnë pasi që atë e konsiderojnë si dhuratë në shenjë falënderimi.

1. Hyrje

Ky raport është pjesë e një misioni më të gjerë të Lëvizjes FOL, që përqendrohet te korrupsioni në institucionet publike të Kosovës. Përmes anketimeve, hulumtimeve, analizave dhe të dhënave të besueshme, FOL synon të ngrisë nivelin e vetëdijes për korrupsionin, përfshirë qytetarët dhe të promovojë luftën kundër korrupsionit në institucionet publike si dhe në proceset e tyre vendim-marrëse.

Qëllimet e veçanta të këtij studimi janë:

- ✓ Përcaktimi i perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve për sa i përket korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor publik në Kosovë.
- ✓ Nxitja e aktivizimit të qytetarët në promovimin e luftës anti-korrupsion në sistemin e shëndetësisë.
- ✓ Fuqizimi i zërit të qytetarëve të Kosovës për një sistem shëndetësor sa më të shëndoshë dhe pa korrupsion.
- ✓ Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së investimeve publike në sistemin e kujdesit shëndetësor publik të Kosovës.

Lëvizja FOL ka vlerësuar se qëllimet e lartpërmendura nuk do të mund të arriheshin pa një hulumtim të opinionit publik rreth perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve për sa i përket korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor publik në Kosovë.

Për të arritur objektivat e këtij studimi, janë realizuar detyrat e mëposhtme:

- Punimi i metodologjisë të hulumtimit.
- Përcaktimi final i mostrës reprezentative në nivelin e Kosovës.
- Zhvillimi dhe pilot testimi i pyetësorëve për studim.
- Krijimi dhe përshtatja e aplikacionit (databazave) për përfshirje të të dhënave nga terreni.
- Përcaktimi i personelit profesional për ta udhëhequr punën në terren.
- Trajnimi i personelit të terrenit – mbikëqyrësve dhe anketuesve.
- Realizimi i intervistave në terren.
- Realizimi i kontrollimit të punës në terreni dhe kontrollimi logjik i pyetësorëve.
- Përfshirja e të dhënave.
- Analizimi i të dhënave.
- Përpilimi i raportit.

Kujdesi Shëndetësor Publik në Kosovë

Sistemi shëndetësor në Kosovë rregullohet me Ligjin për Shëndetësi 2004/4 dhe atë 04/L-125¹. Parimet themelore të kujdesit shëndetësor të definuar nga këto ligje janë: barazia; gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi; cilësia; ndershmëria dhe llogaridhënia; dhënia e prioritetit intervenimeve kost-efektive të kujdesit shëndetësor; qëndrueshmëria dhe vazhdueshmëria; parandalimi dhe zbulimi i hershëm i sëmundjeve; bashkë-përgjegjësia dhe solidariteti. Shërbimet e ofruara nga ky sistem përfshijnë:

- ✓ kujdesin parësor shëndetësor (Promovimin shëndetësor, parandalimin, shërbimet e kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbimet e planifikimit familjar, shërbimet e shëndetit mendor, etj.).
- ✓ kujdesin dytësor shëndetësor (shërbimet spitalore, shërbimet jashtë-spitalore: diagnostike; terapeutike, rehabilituese, transportin emergjent si dhe shërbimet e shëndetësisë publike).
- ✓ kujdesin tretësor shëndetësor (kujdesin e avancuar shëndetësor: spitalor, jashtë spitalor dhe të shëndetësisë publike; shërbimet konziliare dhe transportin emergjent).

Sipas ligjit 04/L-125, financimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës bëhet sipas modelit të kombinuar të financimit, nëpërmjet buxhetit dhe sistemit të sigurimeve shëndetësore, publike dhe private. Mirëpo një fond i sigurimit shëndetësor si pjesë e sistemit të sigurimit publik shëndetësor ende nuk është krijuar si pasojë e mos aprovimit e detyrimit dhe mos implementimit të një ligji specifik për të. Prandaj aktualisht kujdesi shëndetësor publik në Kosovë financohet kryesisht nga buxheti i Kosovës, ai i komunave dhe bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore të cilët nuk janë të liruar. Mirëpo një përqindje e madhe e shpenzimeve shëndetësore mbulohet nga vetë pacientët në formën e shpenzimeve jashtë xhepit. Për më tepër korrupsioni i përhapur në sistemin shëndetësor i rrit dukshëm kostot e qytetarëve për parandalimin dhe shërimin e sëmundjeve të tyre.

¹ Ligji për shëndetësi (2012/04-L-125). Kushtetuta e Kosovës.

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

Ligji për shëndetësi (2004/04). Kushtetuta e Kosovës. <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,113>

2. Metodologjia dhe mostra e hulumtimit

Ky studim është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës, duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar të rëndomtë”, me ç ‘rast popullata e përgjithshme ndahet në grupe më të vogla që njihen si shtresa, duke u bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave:

- Shtresimi i parë është bërë në bazë të përkatësisë etnike, ku janë krijuar tre nën-grupe të ndryshme.
- Shtresimi i dytë është bërë në bazë të vendbanimeve. Për secilën komunë është bërë shtrirja e mostrës në pjesët urbane dhe rurale sipas statistikave zyrtare të ASK-së.
- Shtresimi i tretë është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pikë fillestare).

Pikat fillestare në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë. Hulumtimi është zhvilluar në terren nga data 22 Janar deri më 1 Shkurt 2016. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit $\pm 3.1\%$.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1000 qytetarë të Kosovës, të moshës mbi 18 vjeç: shqiptarë (758), serb (156) dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera (86). Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Para se të administrohet pyetësi në terren, fillimisht është bërë testimi i pyetësorit për të identifikuar problemet logjike dhe përmbajtjesore si dhe është zhvilluar trajnimi i anketuesve.

Përzgjedhja e të anketuarve është bërë përmes këtyre tre fazave:

FAZA E PARË:

Përzgjedhja e shtëpisë përmes teknikës së ecjes sistematike të rastit

Në këtë fazë, anketuesi nga pika fillestare ka përzgjedhur çdo të tretën shtëpi në anën e majtë të rrugës. Në rastet kur shtëpia ka qenë e pabanuar ose kur anketuesi është refuzuar, njësia e banimit është kaluar dhe është vazhduar me qasjen sistematike.

FAZA E DYTË:

Pyetjet përjashtuese – Identifikimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë

Në këtë fazë, qëllimi është identifikimi dhe kontaktimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë. Për këtë fazë, UBO Consulting ka përzgjedhur anëtarin i cili është i moshës mbi 18 vjeç dhe ka vizituar të paktën një herë gjatë vitit 2015 ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor publik.

FAZA E TRETË:

Zhvillimi i intervistave ballë-për-ballë

Gjatë përgatitjes për intervistë, intervistuesi ka sqaruar rëndësinë e ofrimit të përgjigjeve bazuar në bindjet personale të të intervistuarit. Anketimi është realizuar ballë për ballë me të anketuarin pa praninë e anëtarëve tjerë të familjes.

Kontrollimi i cilësisë së anketimit është bërë pas përfundimit të punës në terren, përmes vërtetimit (thirrjeve telefonike dhe vizitave) të 30 për qind të anketave të realizuara. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në programin SPSS, nga i cili janë nxjerrë rezultatet e këtij raporti.


“Tabela më poshtë përmban të dhëna demografike për profilin e të anketuarve. Këto të dhëna nuk janë të peshuara. Në analizën e mëposhtme të dhënat janë peshuar në mënyrë që rezultatet të reflektojnë karakteristikat demografike të Kosovës.”

Profili Demografik i të Anketuarve


Numri i të anketuarve



Numri i të anketuarve



Përqindja e të anketuarve



Vendbanimi

PËRQINDJA E TË
ANKETUARVE

NUMRI I TË
ANKETUARVE

PËRQINDJA E TË
ANKETUARVE


NUMRI I TË
ANKETUARVE

📍 URBAN



466

📍 RURAL



534

Mosha

Mosha	Numri i të anketuarve	Përqindja e të anketuarve
18-24	262	26.2%
25-34	268	26.8%
35-44	204	20.4%
45-54	142	14.2%
55-64	91	9.1%
65+	33	3.3%

Etnia

Etnia	Numri i të anketuarve	Përqindja e të anketuarve
Shqiptar	758	75.8%
Serb	156	15.6%
Boshnjak	4	0.4%
Kroat	1	0.1%
Goran	5	0.5%
Turk	10	1.0%
Rom	17	1.7%
Ashkali	49	4.9%

Rajoni: Mitrovica
Numri i të anketuarve: 173
Përqindja e të anketuarve: 17.3%

Rajoni: Peja
Numri i të anketuarve: 96
Përqindja e të anketuarve: 9.6%

Rajoni: Gjakova
Numri i të anketuarve: 98
Përqindja e të anketuarve: 9.8%

Rajoni: Prizreni
Numri i të anketuarve: 157
Përqindja e të anketuarve: 15.7%

Rajoni: Prishtina
Numri i të anketuarve: 248
Përqindja e të anketuarve: 24.8%

Rajoni: Gjiilan
Numri i të anketuarve: 130
Përqindja e të anketuarve: 13.0%

Rajoni: Ferizaj
Numri i të anketuarve: 98
Përqindja e të anketuarve: 9.8%

Rajoni

3. Rezultatet e studimit

Para prezantimit të të gjeturave të këtij hulumtimi është e domosdoshme të paraqiten edhe disa të dhëna bazë mbi vizitat në institucionet që ofrojnë kujdesin shëndetësor dhe një pasqyrë më të qartë se deri në çfarë shkallë të anketuarit e këtij hulumtimi, janë të kënaqur këto shërbime.

Në figurën 1 në të djathtë mund të shohim se Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë përqindjen më të lartë të vizitave gjatë vitit 2015 dhe pasohen nga spitali e Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Duke qenë se në sistemin e tanishëm, pika e parë kontaktuese për shqetësime shëndetësore janë Qendrat e Mjekësisë Familjare, ku edhe merret referimi te specialistët nëse ka nevojë, atëherë është e kuptueshme që shumica e qytetarëve do të drejtohen aty fillimisht. Qytetarët janë ndarë më të kënaqur me Qendrat e Mjekësisë Familjare se sa me institucionet e tjera të shëndetësisë. Ata janë pyetur të vlerësojnë këto institucione me vlerën nga 1 deri në 5, ku vlera 1 është e barabartë me ‘aspak i kënaqur’ dhe vlera 5 do të thotë të kundërtën. Figura 2 na shpalos se bazuar në këtë shkallë, vlera mesatare e kënaqësisë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është 2.95, e spitalit 2.99, ndërsa Qendrat e Mjekësisë Familjare kryesojnë me 3.49 duke i'u afruar më së shumti nivelit ‘plotësisht i kënaqur’.




Figura 1 - Vizitat në institucionet e kujdesit shëndetësor gjatë vitit 2015 (P1)




Figura 2 - Niveli i kënaqësisë me shërbimet shëndetësore të institucioneve të mëposhtme (P2)

Pakënaqësia me shërbimet e ofruara mund të burojë nga probleme të ndryshme brenda sistemit dhe korrupsioni është vetëm një ndër këto elemente. Prandaj të anketuarve i janë shtruar pyetje specifike mbi korrupsionin në sistemin shëndetësor publik si dhe pyetje për institucionet specifike e stafin përkatës. Më shumë se shumica e qytetarëve të anketuar mendojnë se korrupsioni në institucionet publike të kujdesit shëndetësor në Kosovë është i lartë. Figura 3 më poshtë tregon se afër 15 për qind e të anketuarve mendojnë se korrupsioni është 'shumë i lartë' e 47 për qind të tjerë mendojnë se është 'deri diku i lartë'. Vetëm 28 për qind e konsiderojnë atë si të ulët në Kosovë.




Figura 3 - Niveli i korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor sipas qytetarëve (P3)

Nga figura 4 më poshtë mund të shohim se perceptimi për nivelin e korrupsionit në Kosovë dallon nga rajoni në rajon brenda Kosovës. Rajonet ku përqindja e zhgënjimit të qytetarëve me korrupsionin është më e madhe se mesatarja e përgjithshme për Kosovë janë: Peja, Prizreni e Mitrovica. Tek ato rajone, më shumë se 70 për qind e të anketuarve i janë përgjigjur pyetjes me 'shumë i lartë' ose 'deri diku i lartë'. Rajoni i Ferizajt, Gjakovës dhe Gjilanit janë dukshëm më të ndarë në mendimet e tyre rreth kësaj pyetje.

Vlen të përmendet gjithashtu se të anketuarit të cilët banojnë në zona urbane kanë një përqindje më të lartë të atyre që mendojnë se niveli i korrupsionit është i ulët sesa ata që banojnë në zonat rurale. Figura 5 i prezanton të gjetura për këtë pyetje sipas llojit të vendbanimit.




Figura 4 - Niveli i korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor sipas qytetarëve dhe sipas rajoneve (P3)




Figura 5 - Niveli i korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor sipas qytetarëve dhe zonave të banimit (P3)

Përveç nivelit të korrupsionit në shëndetësi si tërësi, të anketuarit u pyetën gjithashtu për institucione të veçanta. Nga figura 6 në të djathtë mund të shohim se në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson nivelin shumë të lartë të korrupsionit dhe 5 atë shumë të ulët, institucioni më i korruptuar është Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Institucionet më pak të korruptuara sipas respondentëve të anketuar janë Qendrat e Mjekësisë Familjare, të cilat ishin gjithashtu dhe ato me mesataren më të lartë të kënaqësisë. Qendra Klinike Universitare e Kosovës ishte po ashtu institucioni me mesatare më të ulët të kënaqësisë sipas figurës dy më lartë. Pra të gjeturat rreth shkallës se sa janë të kënaqur qytetarët me institucionet shëndetësore përkojnë me mendimet e tyre për nivelin e korrupsionit te po ato institucione.

Për sa i përket përgjegjësve për nivelin e korrupsionit në shëndetësi, nga anketimi i qytetarëve del se personeli mjekësor (38%) dhe qeveria e Kosovës (30%), janë të etiketuar si fajtorët nga pjesa më e madhe e të anketuarve. Në figurën 7 më poshtë mund të gjeni përgjegjësit e tjerë për këtë problem sipas qytetarëve.




Figura 6 - Perceptimi mbi nivelin e korrupsionit në institucionet publike të kujdesit shëndetësor (P4)




Figura 7 - Përgjegjësit për nivelin e korrupsionit në shëndetësi (P5)

Të anketuarit u pyetën gjithashtu për mendimin e tyre rreth ndryshimeve në nivelin e korrupsionit në sistemin shëndetësor përgjatë dy viteve të fundit. Shumica e tyre nuk shohin ndonjë përparim apo edhe përkeqësim të situatës edhe më tutje. Pra në figurën 8 në të majtë mund të shohim se 59 për qind e të anketuarve mendojnë se niveli i korrupsionit në shëndetësi 'ka mbetur i njëjtë' ndërsa 21 për qind janë shprehur se ai 'është rritur' gjatë dy viteve të fundit. Për më tepër, një pjesë e madhe e të anketuarve (40%) mendojnë se asnjë veprim i mirëfilltë nuk po ndërmerret për këtë problem ndërsa një pjesë tjetër pothuajse e barabartë (39%) janë ndarë të pakënaqur me masat e zbatuara. Në figurën 9 më poshtë mund të gjeni perceptimet e qytetarëve rreth politikave apo masave efektive kundër korrupsionit në sistemin shëndetësor.




Figura 8 - Perceptimet mbi ndryshimin në nivelin e korrupsionit në sistemin shëndetësor publik (P6)




Figura 9 - Perceptimet e qytetarëve për zbatimin e politikave apo masave efektive kundër korrupsionit në shëndetësi nga autoritetet publike vendore (P7)

Për të kuptuar më mirë problemet me korrupsionin dhe parregullsitë në institucionet shëndetësore, të anketuarit janë pyetur për përvojat personale në këto vende. Ata shumë shpesh janë ndeshur në situata ku shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike paçka se sistemi jonë shëndetësor duhet ta garantojë këtë. Si pasojë ata kanë qenë të detyruar të shkojnë në institucione private për t'i adresuar problemet e tyre shëndetësore. Në figurën 10 mund të shohim përqindjet e qytetarëve që kanë pasur këtë përvojë me institucionet shëndetësore.

Rajoni më problematik për sa i përket kësaj praktike të gabuar është ai i Mitrovicës sipas të gjeturave të anketës.




Figura 10 - Rastet kur shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike dhe jeni detyruar që të shkoni në ato private (P8)

Aty rreth 73 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se ky fenomen i ka ndodhur 'shpesh' ose 'gjithmonë'. Ndërsa Prizreni është rajoni më përqindjen më të lartë të qytetarëve që nuk kanë hasur asnjëherë në një problem të tillë. Rezultatet për rajonet e tjera të përfshira në këtë anketim, mund t'i gjeni te figura 11 më poshtë.




Figura 11 - Rastet kur shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike dhe jeni detyruar që të shkoni në ato private sipas rajoneve (P8)

Problemet me korrupsionin në stafin e institucioneve publike ekzistojnë që nga infermierët e deri te doktorët si dhe nga vetë qytetarët që japin para apo të mira materiale (jo monetare). Këta të fundit pajtohen në përgjithësi se të gjithë stafit të shëndetësisë pa përjashtim i'u ofrohet ryshfet në formë monetare ose në të mira materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore. Në figurën 12 më poshtë mund të shohim se sa pajtohen të anketuarit me deklaratat të tilla. Vlera 1 do të thotë 'aspak nuk pajtohem' ndërsa vlera 5 nënkupton 'plotësisht pajtohem'. Deklarata për të cilën mesatarja është më së afërti pajtimit të plotë është ajo se doktorëve u ofrohen pagesa joformale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore. Vlen të theksohet se asnjë prej deklaratave nuk ka një mesatare nën vlerën 2.5 që do të përfaqësonte një mos pajtim nga ana e qytetarëve me këto praktika të jashtëligjshme. Pra ofrimi i ryshfeteve kundrejt stafit të institucioneve shëndetësore është mjaft i praktikuar nga qytetarët e Kosovës karshi mjekëve dhe infermierëve.




Figura 12 - Pajtimi me deklaratat për sistemin shëndetësor publik në Kosovë (1) (P9)

Theks i veçantë i është dhënë korrupsionit që mbizotëron tek doktorët si staf kyç i institucioneve shëndetësore. Ndër problemet më të spikatura tek ata sipas pohimeve që morëm nga qytetarët është se doktorët referojnë pacientët në ordinancat e tyre private ose spitalet/klinikat private ku ata punojnë. Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku vlera 1 përfaqëson mospajtim të plotë e ajo 5 të kundërtën, mesatarja për deklaratën më lartë është pothuajse 4 (3.89). Qytetarët po ashtu pajtohen dukshëm me deklaratat tjera si ajo se doktorët në institucionet e kujdesit shëndetësor publik nuk e respektojnë orarin e punës, referojnë pacientët për blerje të barnave tek barnatoret e caktuara, etj. Figura 13 e paraqet shkallën e pajtimit të qytetarëve për problemet e korrupsionit tek doktorët.

Pajtimi me deklaratat për sistemin shëndetësor publik në Kosovë (1)

Kategoria	Pajtimi me deklaratat (%)
Doktorëve u ofrohen pagesa joformale me qëllim të pranimi të shërbimeve më të mira shëndetësore.	3.85
Doktorëve u ofrohen të mira materiale (jo monetare/dhurata) me qëllim të pranimi të shërbimeve më të mira shëndetësore.	3.70
Infermierëve u ofrohen pagesa joformale me qëllim të pranimi të shërbimeve më të mira shëndetësore.	3.41
Personelit teknik (laborantëve, radiologëve etj) u ofrohen pagesa joformale me qëllim të pranimi të shërbimeve më të mira shëndetësore.	3.39
Personelit teknik (laborantëve, radiologëve etj) u ofrohen të mira materiale (jo monetare) me qëllim të pranimi të shërbimeve më të mira shëndetësore.	3.28
Infermierëve u ofrohen të mira materiale (jo monetare) me qëllim të pranimi të shërbimeve më të mira shëndetësore.	3.27

1.00 5.00

Aspak nuk pajtohem Plotësisht pajtohem

Figura 13 – Pajtimi me deklaratat për sistemin shëndetësor publik në Kosovë (2) (P10)

Qytetarët u pyetën gjithashtu se çfarë mendojnë ata për mekanizmat e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor publik, që kanë për qëllim ndëshkimin e rasteve të korrupsionit. Gjysma e të intervistuarve u përgjigjën me ‘nuk pajtohem’ ose ‘aspak nuk pajtohem’ që institucionet i kanë ndërtuar dhe i respektojnë këto mekanizma. Siç mund të shihet edhe në figurën 14 më poshtë vetëm 2 për qind e të anketuarve u pajtuan plotësisht me këtë deklaratë.

Pajtimi me deklaratën: "Institucionet publike të kujdesit shëndetësor kanë të ndërtuar mekanizma dhe i respektojnë ato për të ndëshkuar doktorët dhe stafin tjetër të përfshirë në rastet korruptive."




Figura 14 - Pajtimi me deklaratën: "Institucionet publike të kujdesit shëndetësor kanë të ndërtuar mekanizma dhe i respektojnë ato për të ndëshkuar doktorët dhe stafin tjetër të përfshirë në rastet korruptive." (P11)

Sic u përmend edhe më lartë, problemi me korrupsionin nuk qëndron vetëm te të korrumpuarit por edhe te korrupsuesit. Nga të gjeturat më lartë, e pamë se korrupsioni i stafit shëndetësor është një praktikë e zakonshme. Për më tepër figura 15 në të djathtë na tregon se rreth 28 për qind e të anketuarve, kanë shfrytëzuar lidhjet e tyre personale apo ato familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit. Mund të shohim gjithashtu se afër 10 për qind nuk kanë pranuar të përgjigjen, gjë që na bënë të mendojmë se përqindja e atyre që kanë përdorur njohjet e tyre është në realitet edhe më e lartë se 28 për qind.

Rajonet me më së shumti individë që kanë pranuar shfrytëzimin e lidhjeve personale janë Peja e Gjakova, ku afër gjysma e të anketuarve (48%) kanë pohuar një gjë të tillë. Njëkohësisht Peja ishte dhe rajoni me përqindjen më të lartë të të anketuarve që janë të mendimit se niveli i korrupsionit në shëndetësi është i lartë (shih figurën 4). Të dhënat për rajonet e tjera janë prezantuar në figurën 16 më poshtë.

Shfrytëzimi i lidhjeve personale ose familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore




Figura 15 - Shfrytëzimi i lidhjeve personale ose familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore (P12)




Figura 16 - Shfrytëzimi i lidhjeve personale ose familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore (P12)

Mirëpo shfrytëzimi i njohjeve personale jo detyrimisht përbën ofrimin e ryshfeteve apo korrupsionin në një mënyrë tjetër të stafit shëndetësor. Prandaj ne gjithashtu i kemi pyetur drejtpërdrejtë qytetarët nëse e kanë kryer një akt të tillë. Në figurën 17, mund të shohim të gjeturat e kësaj pyetje. Është e mundur që një person të ketë ofruar edhe para edhe të mira materiale dhe për këtë

arsye shuma e përqindjeve të prezantuara mund të jetë mbi 100 për qind. Vetëm 77 për qind e të anketuarve kanë mohuar korrupsionin e stafit shëndetësor ndërsa 16 për qind kanë dhënë para e 9 për qind të mira materiale (jo monetare). Duhet të i'u rikujtojmë se këto rezultate përfshijnë vetëm ata persona që janë deklaruar hapur për pjesëmarrje në korrupsion e ndërsa përqindja e





Figura 17 - Dhënia e parave apo të mirave të tjera jo monetare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit (P13)

vërtetë e atyre që kanë bërë një gjë të tillë mund të jetë edhe më e lartë. Dhënia e parave është më e hapur te gjinia mashkullore se ajo femërore. Në figurën 18 më poshtë mund të shohim se 20 për qind e meshkujve e kanë pranuar një gjë të tillë kundrejt vetëm 13 për qind të femrave.



Vlera monetare e parave ose të mirave materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë 2015

Kategoria	Vlera (€)
Shuma mediane në Euro	€ 62.72
Shuma mesatare në Euro	€ 101.33

Minimumi € 5 € 104 € 203 € 302 € 401 € 500 Maksimumi € 599

[23]

Numri i rasteve të dhënies së parave ose të mirave materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë vitit 2015

Pyetje	Numri i rasteve
Trego sa herë keni dhënë të mira materiale gjatë vitit 2015 (N=94)	1.92
Trego sa herë keni dhënë para gjatë vitit 2015 (N=163)	1.84

[24]




Figura 21 - Vlera monetare e parave ose të mirave materiale për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë vitit 2015 sipas gjinisë (P14)

Sic mund ta shohim nga figura 21 në të djathtë, meshkujt përveç se kanë pohuar më shpesh dhënien e parave se femrat, ata gjithashtu kanë dhënë sasi më të mëdha. Një mashkull jep mesatarisht 121 euro për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore e ndërsa një femër rreth 76 euro. Edhe shuma mediane dallohet nga gjinia, 69 euro për meshkuj e 50 euro për femra. Pra meshkujt dukshëm japin para më shpesh e më shumë se femrat për shërbime shëndetësore publike.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu se nëse dhënia e parave apo e të mirave materiale ishte vënë si kusht nga stafi shëndetësor apo kishte qenë në mënyrë vullnetare. Meqë të anketuarit kanë dhënë para apo gjësende më shumë se një herë, ata kanë mundur të përgjigjen më shumë se njëherë. Në figurën 23 më poshtë mund të shohim se nuk ka dallim të madh në mes përqindjes së njerëzve që kanë qenë të kushtëzuar dhe atyre që kanë dhënë në mënyrë vullnetare. Mirëpo po të përqendrohemi tek personat që kanë dhënë vetëm para ose vetëm të mira materiale, rezultatet dallojnë dukshëm. Në figurën 22 më poshtë mund të shohim se 66 për qind e atyre që kanë dhënë vetëm para, kanë qenë të kushtëzuar nga stafi i kujdesit shëndetësor publik. Në anën tjetër 89 për qind e të anketuarve që kanë pohuar dhënien e të mirave materiale, e kanë bërë atë në mënyrë vullnetare.




Figura 22 - Arsyet e dhënies së parave dhe të mirave materiale (P15)




Figura 23 - Arsyet e dhënies së parave apo të mirave materiale (P15)

Raportimi i këtyre rasteve të korrupsionit pothuajse nuk ndodh asnjëherë sipas përgjigjeve të qytetarëve. Në figurën 24 mund të shohim se rreth 98 për qind e të anketuarve nuk e kanë paraqitur rastin e dhënies së parave apo të mirave materiale tek autoritetet përkatëse. Pra vetëm 5 persona prej 233 të anketuarve që kanë dhënë para apo të mira materiale (jo monetare), kanë pranuar se i kanë paraqitur rastet në organet përkatëse. Dy prej tyre i kanë thënë se i kanë raportuar organeve kompetente të institucionit shëndetësor ndërsa të tjerët policisë, agjencionit kundër korrupsionit dhe një ka refuzuar të përgjigjet. Sipas përgjigjeve të këtyre personave, për ata që kanë raportuar organeve kompetente të institucionit shëndetësor ose nuk është marrë ndonjë veprim ose janë këshilluar të tërheqin denoncimin. Asnjë masë nuk është ndër marrë as sipas atij/asaj që ka raportuar te agjencioni kundër korrupsionit. Ndërsa për personin që ka refuzuar të përgjigjet se ku ka raportuar, është nisur procedura zyrtare e hetimit të rastit.




Figura 24 - Paraqitja e rasteve të korrupsionit para autoriteteve/institucioneve zyrtare (P16)

Të anketuarit u pyetën gjithashtu për arsyet e mos paraqitjes së rasteve të korrupsionit te institucionet përkatëse. Më shumë se çereku i të anketuarve nuk e shohin të arsyeshëm raportimin sepse ata kanë pasur dobi nga dhënia e parave/dhuratave. Pra për ta, paratë në këtë rast shërbejnë si mjet këmbimi dhe jo si instrument i korrupsionit. Një pjesë tjetër e qytetarëve, rreth 24 për qind, ndjehen të dekurajuar sepse mendojnë se askush nuk do t'i dijë për raportimin e rasteve të korrupsionit.

Shpesh ofrimi i shërbimeve shëndetësore shihet si nder e jo si detyrë e stafit sepse një përqindje e madhe e të anketuarve (20%) dhënie e parave apo të mirave materiale, nuk e raportojnë pasi që atë e konsiderojnë si dhuratë në shenjë falënderimi. Kjo dukuri është më e shprehur te gjinia femërore se ajo mashkullore. Gjithashtu një përqindje më e lartë e femrave të anketuara sesa e meshkujve, nuk e kanë paraqitur rastin te institucionet përkatëse nga frika për pasojat. Arsyet e tjera që janë treguar nga të anketuarit mund t'i gjeni te figura 25 dhe ajo 26 më poshtë.




Figura 26 - Arsyet e mosparaqitjes të rasteve të korrupsionit tek institucionet përkatëse (P19)




Figura 25 - Arsyet e mosparaqitjes të rasteve të korrupsionit tek institucionet përkatëse sipas gjinisë (P19)

4. Përfundime

Përmes këtij studimi Lëvizja FOL ka patur për qëllim analizimin e opinionit publik rreth perceptimeve dhe përvojave në raport me korrupsionin në sistemin e kujdesit shëndetësor publik në Kosovë. Anketimi u zhvillua përgjatë periudhës Janar-Shkurt, ku morën pjesë 1000 qytetarë të Kosovës mbi 18 vjeç të cilët kanë vizituar të paktën një herë një prej institucioneve të shëndetit publik në Kosovë. Me anë të të dhënave të dala nga ky studim, ne synojmë të shpalosim përvojat e qytetarëve në këtë sektor shumë të rëndësishëm të mirëqenies dhe njëkohësisht të rrisim nivelin e vetëdijes për korrupsionin dhe të promovojmë luftën kundër korrupsionit në institucionet publike si dhe në proceset e tyre vendim-marrëse.

Përfundimet kryesore të dala nga analiza e të dhënave janë të përmbledhura në vazhdim. Qytetarët e Kosovës kishin vizituar më së shpeshti Qendrat e Mjekësisë Familjare gjatë vitit 2015. Këto institucione kishin mesataren më të lartë të nivelit të kënaqësisë e ndërsa Qendra Klinike Universitare kishte nivelin më të ulët. Kjo e fundit perceptohet edhe si më e korruptuara nga qytetarët e anketuar.

Gjithsesi të anketuarit në përgjithësi mendojnë se korrupsioni në shëndetësi është i lartë në Kosovë. Shumica prej tyre ia vënë fajin personelit mjekësor dhe qeverisë së Kosovës për këtë fenomen të përhapur. Ata nuk parë ndonjë përparim apo edhe përqendrim të situatës së korrupsionit të përhapur në shëndetësi. Për më tepër, një pjesë e madhe e të anketuarve mendojnë se asnjë veprim i mirëfilltë nuk po ndërmerret për këtë problem.

Ata shumë shpesh janë ndeshur në situata ku shërbimet shëndetësore nuk janë ofruar në institucionet publike edhe pse sistemi jonë shëndetësor duhet ta garantojë këtë. Si pasojë, ata kanë qenë të detyruar të shkojnë në institucione private për t'i adresuar problemet e tyre shëndetësore. Problemet me korrupsionin në stafin e institucioneve publike ekzistojnë që nga infermierët e deri te doktorët si dhe nga vetë qytetarët që japin para apo të mira materiale (jo monetare). Mirëpo pajtimin më të madh të qytetarët e kemi gjetur për praktikën e korrupsionit tek doktorët. Ndër problemet më të spikatura tek ata sipas pohimeve që morëm nga qytetarët është se doktorët referojnë pacientët në ordinancat e tyre private ose spitalet/klinikat private ku ata punojnë. Qytetarët po ashtu u pajtuan dukshëm me deklaratat e tjera si ajo se doktorët në institucionet e kujdesit shëndetësor publik nuk e respektojnë orarin e punës, referojnë pacientët për blerje të barnave tek barnatoret e caktuara, etj.

Për sa i përket praktikës së korrupsionit nga ana e vetë qytetarëve, më shumë se çereku i të anketuarve e pranuan se kanë shfrytëzuar lidhjet e tyre personale apo ato familjare për të pranuar shërbime më të mira shëndetësore gjatë 12 muajve të fundit. Ndërsa kishte edhe një përqindje të konsiderueshme që nuk dëshiroi t'i përgjigjej kësaj pyetje, gjë që na la të dyshojmë se përqindja e atyre që kanë përdorur njohjet e tyre është në realitet edhe më e lartë. Veç kësaj, një pjesë e konsiderueshme e tyre na pohuan se kanë dhënë para ose të mira materiale (jo monetare) për të pranuar shërbime më të mira në institucionet e kujdesit shëndetësor publik. Ata kishin dhënë më së paku 1 herë e më së shumti 5 herë gjatë 2015-tës. Mesatarja për dhënien e të mirave materiale (jo monetare) ishte 1.92 herë, e për para ishte 1.84. Shuma minimale për qytetarët të cilët pohuan dhënien e parave apo të mirave materiale, ishte 5 euro

e ajo maksimale 600 euro. Për më tepër, shuma mesatare qëndronte te 101 euro e ndërsa shuma mediane ishte afër 63 euro. Kjo e fundit na tregon se shumat më të vogla janë më të shpeshta. Çfarë e bën këtë rezultat edhe më shqetësues është se 66 për qind e atyre që kanë dhënë vetëm para, kanë qenë të kushtëzuar nga stafi i kujdesit shëndetësor publik. Pra mund të shihet se praktikat e dhënies së rryshfetit janë tejet të zakonshme dhe të pranuar në shoqërinë tonë.

Për më tepër, raportimi i këtyre rasteve të korrupsionit pothuajse nuk ndodh asnjëherë sipas përgjigjeve të qytetarëve. Më shumë se çereku i të anketuarve nuk e shihnin të arsyeshëm raportimin sepse ata kishin pasur dobi nga dhënia e parave/dhuratave. Një pjesë tjetër e qytetarëve mendonin se askush nuk do t'ia dijë për raportimin e rasteve të korrupsionit. Shpesh ofrimi i shërbimeve shëndetësore shihet si nder e jo si detyrë e stafit sepse një përqindje e madhe e të anketuarve dhënien e parave apo të mirave materiale, nuk e raportojnë pasi që atë e konsiderojnë si dhuratë në shenjë falënderimi.

Në përgjithësi nga rezultatet e këtij studimi mund të dalim në përfundim se sistemi shëndetësor publik në Kosovë, është dukshëm i korruptuar nga të dy anët, si ajo e stafit dhe ajo e pacientëve. Dhënia e parave apo të mirave materiale është mjaft e normalizuar në shoqërinë tonë dhe duket se përbën një praktikë të zakonshme gjatë vizitave te këto institucione. Bindja se stafi mjekësor është dukshëm i korruptuar është mjaft e përhapur tek qytetarët, gjë që mund të shpjegojë edhe nivelin e pakënaqësisë së tyre me këtë sistem. Për më tepër ata janë të zhgënjyer nga politikat e marra deri më tani dhe kanë pak besim se ky fenomen mund të luftohet, gjë që shihet nga përqindjet minimale të raportimit si dhe pjesës të konsiderueshme që deklarohet se askush nuk do t'ia dijë për rastet e korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor publik në Kosovë.

Referenca

Ligji për shëndetësi (2012/04-L-125). Kushtetuta e Kosovës.

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Liqjet/Liqji%20per%20shendetesi.pdf>

Ligji për shëndetësi (2004/04). Kushtetuta e Kosovës.

<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,113>

Publikimi i këtij Raporti u mundësua me përkrahjen e Fondit Kanadez për Nisma Lokale (CFLI). Ky Raport është përgatitur nga stafi i Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Ndërsa, të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.



www.levizjafol.org | info@levizjafol.org
Rr. Andrea Gropa No.35 10000 Prishtinë – Kosovë